

**REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM KORÇË  
PËR VITIN 2024**

Nr. Rendor <sup>1</sup>	Data e kërkesës <sup>2</sup>	Objekti i kërkesës <sup>3</sup>	Data e përgjigjes <sup>4</sup>	Përgjigje <sup>5</sup>	Mënyra e përfundimit të kërkesës <sup>6</sup>	Tarifa <sup>7</sup>
1.	03.01.2024	Kërkesë për informacion mbi numrin e çështjeve të organizuara me short manual kur sistemi i çështjeve nuk ka funksionuar në mënyrë të dokumentuar për periudhën nga viti 2018 deri ne datën 22 dhjetor 2023 nga z. A.K	08.01.2024	Për çështjet të organizuara me short manual kur Sistemi Elektronik i Menaxhimit të Çështjeve Gjyqësore (ICMIS), nuk ka funksionuar për vitet 2018 - 22 dhjetor 2023, në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, nuk ka patur asnjë rast që çështjet të jenë organizuar me short manual si pasoje e mosfunksionimit të sistemit.	E plotë	Nuk ka

<sup>1</sup>Numri rendor i kërkesave të regjistruara në Regjistrin e Kërkesave dhe Përgjigjeve

<sup>2</sup>Data e regjistrimit të kërkesës

<sup>3</sup>Përmbledhje e objektit të kërkesës duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>4</sup>Data e kthimit të përgjigjes

<sup>5</sup>Përmbajtja e përgjigjes duke u anonimizuar sipas parashikimeve ligjore në fuqi

<sup>6</sup>Përgjigja jepet E plotë/ E kufizuar/E refuzuar/E deleguar

<sup>7</sup>Kosto monetare e riprodhimit (kur është rasti dhe e dërgimit) të informacionit të kërkuar sipas tarifave të publikuar nga autoriteti publik.

2.	09.01.2024	Kërkesë për informacion nga Organizata SCIDEV, në të cilën kërkohet vendosja në dispozicion e informacionit lidhur me numrin e padive gjyqësore me palë gazetarët ose punonjësit e medias për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023 si dhe stadin e shqyrtimit të tyre.	10.01.2024	Nga verifikimi nuk rezulton të jetë depozituar pranë Gjykatës e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë për periudhën Janar 2023-Dhjetor 2023 asnjë kërkesëpadi me palë gazetarë apo punonjës media.	E plotë	Nuk ka
3.	01.02.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit ndaj shtetases A.S nga z. F.Zh	08.02.2024	Vënë në dispozicion vendimi i anonimizuar	E kufizuar	Nuk ka
4.	08.02.2024	Kërkesë për informacion sa është numri i çështjeve në të cilat Gjykata e Korçës ka lejuar martesën e një shtetasi të mitur, nën moshën 18 vjeç, në zbatim të nenit 7 të Kodit të Familjes, gjatë viteve 2017-2023? Sa prej tyre janë femra dhe sa janë meshkuj? Nga znj.M.R	13.02.2024	Në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë, për periudhën 2017-2023 është depozituar vetëm 1 (një) kërkesë me objekt “Lejim lidhje martese” sipas nenit 7 të Kodit të Familjes. Gjykata me vendimin e saj, ka pranuar kërkesën duke lejuar lidhjen e martesës së një shtetase (femër) nën moshën 18 vjeç.	E plotë	Nuk ka

5.	19.02.2024	Kërkesë për informacion mbi numrin e kërkesave të depozituara pranë gjykatës së Korçës me objekt “zgjidhje martese” për vitet 2022-2023. Nga gazetari T.F “Vizion Plus”	19.02.2024	Mbi numrin e kërkesave me objekt “zgjidhje martese” për vitet 2022-2023 ju bëjmë me dije se: Për vitin 2022 janë depozituar 398 kërkesa. Për vitin 2023 janë depozituar 402 kërkesa.	E plotë	Nuk ka
6.	23.02.2024	Kërkesë për vënie në dispozicion të vendimit ndaj shtetasit A.P nga znj. A.C	26.02.2024	Vënë në dispozicion vendimi i anonimizuar	E plotë	Nuk ka
7.	26.02.2024	Kërkesë për informacion Sa vepra penale kryer nga të miturit janë regjistruar përgjatë vitit 2023 dhe vitit 2024, dhe cilat janë këto vepra penale nga gazetarja. S.Liçkollari “Sot7”	05.03.2024	Gjatë vitit 2023 në Gjykatën e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Korçë janë regjistruar gjithsej 5 çështje penale me të mitur dhe janë gjykuar 4 prej tyre, Nisur nga të dhënat e mësipërme rezulton se kriminaliteti për të mitur në Rrethin Gjyqësor Korçë kryesisht karakterizohet nga veprat penale me rrezikshmëri	E plotë	Nuk ka

				të ulët dhe të lartë, ndërsa nuk ka raste të veprave penale me rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore. Konkretisht gjate vitit 2023 jane gjykuar 4 çështje penale me të pandehur të mitur. Veprat më të përhapura të gjykuara nga të miturit janë Dhunë në familje, Ndihme për kalim të paligjshëm të kufijve, shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor, largim nga vendi i aksidentit.		
8.	28.02.2024	Kërkesë për informacion Sa kërkesa për urdhëra mbrojtje janë depozituar ne gjykatë gjate vitit 2023 dhe në dy muajt e pare të vitit 2024. Nga cila zone dhe çfarë grupmoshë janë regjistruar si dhe statusi shoqeror i kërkuessve nga gazetarja K.Koçi “RTSH Korça”	01.03.2024	Vënë në dispozicion statistikat mbi urdhërat e mbrojtjes.	E plotë	Nuk ka